



Prishtinë: 14.10.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1191_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1967_07_19**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **12.09.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 14.10.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.Sh. nga Deçan me shifër të konsumatorit DFE - 22019 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1967_07_19** i datës 18.07.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 12.09.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori A.Sh. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se falënderon DMK në ZRRE për vendimin pozitiv, por sipas konsumatorit vendimi është i pjesshëm pasi që nuk është vlerësuar dëmi i shkaktuar ndaj tij dhe se borxhi i ngarkuar ndaj tij është i padrejtë. Konsumatori në ankesën e tij ka bërë shpjegimin e rastit në mënyrë kronologjike nga procesverbali parë i ndërrimit të njehsorit elektrik i datës 05.03.2016, faturimi i muajit 03/2016 e deri te përgjigja e KESCO-s ndaj ankesës së konsumatorit për faturën e muajit 03/2016. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kërkon që të bëhet rivlerësim i drejtë i borxhit të energjisë elektrike pasi që KESCO ka bërë zbritjen e pjesshme të borxhit nga 318.69€ në 267.00€ dhe kërkon që të kompensohet për dëmet e shkaktuara në shtëpi dhe për ditët e humbura.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se falënderon DMK në ZRRE për vendimin pozitiv, por sipas konsumatorit vendimi është i pjesshëm pasi që nuk është vlerësuar dëmi i shkaktuar ndaj tij dhe se borxhi i ngarkuar ndaj tij është i padrejtë, Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkallës



së parë ka analizuar vetëm faturat e energjisë elektrike të kontestuar nga konsumatori në KESCO nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 në vlerë 318.69€ dhe si dhe faturën nr.04160DPE-22019 të datës 26.04.2016 në vlerë prej 92.98€, dhe se kjo ka qenë ankesa e juaj drejtuar ZRRE-së dhe e cila ankesë është bërë edhe në KESCO. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë ka bërë analizimin e ankesës së konsumatorit dhe ka bërë korrigjimet për faturat e lartcekura, ku për faturën nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 në vlerë 318.69€ është kërkuar që të shkarkohet konsumatori nga borxhi i përgjithshëm dhe se për periudhën 20 ditore (periudhë e mbetur e faturimit 03/2016) ta ngarkoj duke u bazuar në shpenzimin ditor të faturës nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 (njehsori nr.7603544) dhe pastaj ta ngarkon për 20 ditët e mbetura të faturës 03/2016, si dhe për faturën nr.04160DPE-22019 të datës 26.04.2016 është kërkuar që të korrigjohet kjo faturë ashtu që t'i zbret periudhën 6 ditore nga periudha e faturimit dhe për atë periudhë 6 ditore ta ngarkoj me shpenzimin ditor të faturës nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 (njehsori nr.7603544). Bordi i ZRRE-së thekson se në ankesën e juaj drejtuar KESCO dhe në ZRRE keni kontestuar faturimin e energjisë elektrike të muajit 03/2016 për shkak të defekteve të shkaktuar nga punëtorët e KEDS-it në njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra shkresave të lëndës respektivisht procesverbaleve të cekur më lartë, vërehet se njehsori nr.64643443 është vendosur nga punëtorët e KEDS për matje të shpenzimit të energjisë elektrike me datë 05.03.2016 përmes procesverbalit nr.0182507, ndërsa me datë 31.03.2016 nga punëtorët e KEDS-it është theksuar se njehsori në fjalë ka disa defekte, respektivisht është konstatuar se (N) në njehsor shndërrohet në fazë (L1), dhe se pas heqjes së siguresës (L1) njehsori me dy fazat e mbetura ka funksionuar në rregull dhe është ndalur zbraza elektrike ne tokëzim dhe pastaj është rregulluar njehsori. Gjithashtu vlen të theksohet se me datë 07.04.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS gjatë inspektimit kanë konstatuar se gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik është shpuar kabli që furnizon shtëpinë dhe se për këtë janë edhe fotot si dëshmi dhe bëhet rregullimi i njehsorit. Duke analizuar këto procesverbale vërehet se njehsori elektrik nr.64643443 nga momenti i vendosjes së tij më datë 05.03.2016 e deri kur është bërë edhe faturimi i energjisë elektrike me datë 25.03.2016 ka regjistruar shpenzim prej TL=2197 kWh dhe TU=1214 kWh, ndërsa konstatimi për defekt të njehsorit dhe rregullimi i tij ka ndodhur me datë 31.03.2016. Duke parë këto konstatime të bëra në procesverbalet e KEDS, Bordi i ZRRE-së ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit para dhe pas periudhës kontestuese dhe ka vërejtur se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike, por që ka dallim me periudhën kontestuese 03/2016. Mesatarja mujore e shpenzimit me njehsorin elektrik nr.64643443 para periudhës kontestuese: për periudhën 05/2014 deri në periudhën 12/2014 është 401.63 kWh/muaj, për periudhën 05/2015 deri në periudhën 12/2015 është 418.25 kWh/muaj, ndërsa për periudhën pas periudhës kontestuese prej periudhës 05/2017 deri më 12/2017 është 408.15 kWh/muaj dhe prej periudhës 05/2018 deri më 12/2018 është 287.88 kWh/muaj. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike vërehet qartë se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike për periudha para dhe pas periudhës kontestuese, por ka dallim të madh me periudhën 03/2016 kur konsumatori është faturuar prej 3,411 kWh/muaj. Bazuar në këtë Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë në ZRRE ka vepruar drejtë kur ka kërkuar nga KESCO që të korrigjon faturat nr.0316102829DPE-22019 dhe nr.04160DPE-22019 të datës 26.04.2016, pasi që njehsori elektrik ka pasur defekte teknike dhe se gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik njehsori elektrik është shpuar.

Bordi i ZRRE pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës konstaton se konsumatorit me shifër DPE – 22019 për muajin 03/2016 KESCO ia ka dërguar dy fatura: njëra faturë me nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 e me shpenzim të njehsorit nr.7603544 (njehsori jo kontestues) dhe e cila paraqet shpenzimin e energjisë elektrike nga faturimi i majit 02/2016 (data 25.02.2016) e deri më 05.03.2016, pra për periudhën 9 ditore është faturuar prej 363 kWh, ndërsa fatura tjetër e energjisë



elektrike nr.03160DPE-22019 e datës 25.03.2016 ka ardhur me shpenzimet e njehsorit nr.64643443 (njehsori kontestues) dhe e cila paraqet shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit prej periudhës 05.03.2016 (kur është montuar) e deri më datën e faturimit 25.03.2016, pra për periudhën 20 ditore është faturuar prej 3,411 kWh. Bordi i ZRRE-së thekson se konsumatori është faturuar edhe për periudhën 04/2016 me datë 26.04.2016 me shpenzimet e njehsorit nr.64643443 (njehsori kontestues) dhe se kjo faturë përfshin periudhën prej 25.03.2016 deri më 26.04.2016 dhe atë me shpenzim prej 1,453 kWh. Bordi i ZRRE-së potencon se pas analizimit të këtyre faturave dhe duke u bazuar në procesverbalet nr.0182507 të datës 05.03.2016, procesverbalin nr.1704167 të datës 31.03.2016, si dhe procesverbalin nr.1704407 të datës 07.04.2016, konstatojnë se fatura nr.03160DPE-22019 e datës 25.03.2016 dhe fatura nr. 04160DPE-22019 e datës 26.04.2016 nuk paraqesin shpenzim real mujore të energjisë elektrike për shkak të defektit të njehsorit elektrik dhe mospërputhjes së shpenzimit të energjisë elektrike të këtyre periudhave me periudhat para dhe pas periudhës kontestuese. Andaj lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së konstatojnë se KESCO ashtu siç ka vendosur edhe organi i shkallës së parë duhet të korrigjoj konsumatorin për faturat e mësipërme: pra që faturën nr.03160DPE-22019 e datës 25.03.2016 me shpenzim prej 3,411 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 318.69€ ta shkarkoj nga borxhi përgjithshëm, dhe se për periudhën e mbetur 20 ditore (periudhë e mbetur e faturimit 03/2016) ta ngarkoj duke u bazuar në shpenzimin ditor të faturës nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 (njehsori nr.7603544) dhe pastaj ta ngarkon për 20 ditët e mbetura të faturës 03/2016, si dhe faturën nr.04160DPE-22019 e datës 26.04.2016 ta korrigjoj ashtu që tja zbret periudhën 6 ditore nga periudha e faturimit dhe për atë periudhë 6 ditore dhe atë ta ngarkoj me shpenzimin ditor të faturës nr.0316102829DPE-22019 të datës 25.03.2016 (njehsori nr.7603544).

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit ku kërkon që të bëhet rivlerësim i drejtë i borxhit të energjisë elektrike pasi që KESCO ka bërë zbritjen e pjeshme të borxhit nga 318.69€ në 267.00€ dhe kërkon që të kompensohet për dëmet e shkaktuara në shtëpi dhe për ditët e humbura, Bordi i ZRRE-së thekson se ashtu siç u theksua edhe më lartë, organi i shkallës së parë konform mandatit të tij ligjor ka bërë shqyrtimin e ankesës suaj dhe ka nxjerr një vendim dhe i cili ka bërë rivlerësimin e faturës së kontestuar të muaji 03/2016 ku ka bërë korrigjimet e nevojshme në faturim për këtë periudhë. Bordi i ZRRE-së pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës konstatojnë se korrigjimet e bëra nga organi i shkallës së parë janë të sakta dhe janë të bazuar në dispozita ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, dhe se nuk ka elemente tjera të korrigjimit financiar që do të duhej t'i bëheshin konsumatorit. Ndërsa sa i përket kërkesës së konsumatorit lidhur me kompensimin për dëmet e shkaktuara në shtëpi dhe për ditët e humbura nga ky defekt, Bordi i ZRRE thekson se ZRRE nuk ka mandat ligjor të bëjë vlerësimin apo kompenzimin e dëmeve të shkaktuara si rezultat i defekteve të evidentuara në procesverbalet e inspektimit dhe të ndërrimit të njehsorit elektrik dhe se për këtë ju duhet t'i drejtoheni institucioneve gjyqësore për të kërkuar kompensim dëmi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke kërkuar kompensim dëmi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit A.Sh.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.